



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E FINANCËS

**INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE
DHE SHPENZIMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2021, PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021**

Në zbatim ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimit plotësues nr.4 datë 25.01.2021 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", VKB nr. 147 datë 28.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 17 datë 04.02.2021 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2020 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2021, si dhe për një ndryshim në buxhetin e miratuar me VKB nr.147 datë 28.12.2020”, po ju informojmë në lidhje me ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, në buxhetin e vitit 2021, për periudhën janar-qershor 2021.

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2021 është planifikuar në vlerën **1,930,355** mijë lekë dhe realizimi për periudhën janar-qershor 2021 ka qenë **688,845** mijë lekë ose **36%**.

Realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka qenë 356,758 mijë lekë ose 36% në krahasim me planin e vitit 2021 në vlerën 1,000,926 mijë lekë.

Detyrimet e mbartura të vitit 2020 në buxhetin e 2021 ishin në vlerën 172,004 mijë lekë dhe realizimi për periudhën janar-qershor 2021 ka qenë 111,453 mijë lekë ose në masën 65%, nga të cilat shpenzimet korrente janë likuajduar në masën 94%, kurse shpenzimet për investime në masën 30%. Institucionet e varësisë i kanë likuajduar detyrimet e mbartura në masën 100%, kurse Bashkia në masën 48%.

Detajimi i buxhetit sipas llogarive ekonomike paraqitet si më poshtë:

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë planifikuar në vlerën 733,365 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 322,246 mijë lekë ose 44%.

Shpenzimet korrente janë planifikuar në vlerën 864,242 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 321,974 mijë lekë ose 37%.

Shpenzimet për investime janë planifikuar në vlerën 285,198 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 27,641 mijë lekë ose 10%.

Shpenzimet për principalin dhe interesin janë planifikuar në vlerën 47,550 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 16,984 mijë lekë ose 36%.

Bashkangjitur:

Tabela nr. 1 e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, dhe të ardhurat e Institucioneve të Varësisë për periudhën janar-qershor 2021

Tabela nr. 2 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën janar-qershor 2021

Tabela nr. 3 e realizimit të shpenzimeve nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për periudhën janar-qershor 2021

Tabela nr. 4 e realizimit të shpenzimeve nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe sponsorizimet për periudhën janar-qershor 2021

Tabela nr. 5 e detajimit të shpenzimeve operative (detyrime 2020) që kanë si burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, transfertën e pakushtëzuar, të ardhurat e trashëguara nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të vitit 2021

Tabela nr. 6 e detajimit të shpenzimeve për investime (detyrime 2020) që kanë si burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, transfertën e pakushtëzuar, të ardhurat e trashëguara nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të vitit 2021

DREJTORIA E FINANCËS

Valbona ZIKO

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE
E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela DISHNICA

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Soniel PRIFTI

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Benila THEMELI